

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



01

NËNSHKRIMI I KONTRATAVE PËR INFRASTRUKTURË RINORE ME 6 NJËSITË E VETËQEVERISJEVE VENDORE FITUESE TË THIRRJES SË TRETË PËR GRANTE PËR INFRASTRUKTURË RINORE.

Nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR) u nënshkruan kontratat me **Bashkinë e Fierit, Matit, Malësisë së Madhe, Librazhdit, Sarandës dhe Korçës**, si fitues të granteve për infrastrukturë rinore nga thirrja e tretë që po financohet me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet AKR-së, duke shënuar kështu një hap të ri bashkëpunimi me impakt të drejtëpërdrejtë në rritjen e hapësirave në dispozicion të të rinjve në 6 bashki të vendit.

Fokusi i projekteve të bashkive fituese është rikonstruktimi apo ndërtimi i një qendre rinore për qytetin, të konceptuara edhe si hapësira multifunksionale, ku të rinjtë angazhohen në trajnime, kurse të ndryshme, teknologji, sipërmarrje, këshillim karriere, debat, lexim dhe për aktivitete të ndryshme rinore e bashkëbisedime.

Në total, nga mbështetja me grant **për bashkitë e sipërpërmendura pritet që të ndikohen rreth 108 233 të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç**, të cilët do të kenë mundësi të angazhohen në aktivitete kulturore dhe sociale, dhe do të jenë pjesë e qendrave rinore financuar nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë.



02

MBAHET PANAJRI I RADHËS I EDUKIMIT, TRAJNIMIT DHE PUNËSIMIT NË QARKUN FIER

Gjatë muajit mars, në kuadër të nismës **“Panair Edukimi, Trajnimi dhe Punësimi në çdo qark”** u mbajt panairi i radhës në qarkun e Fierit me 30 aktorë që ofruan mundësi për mbi 200 të rinj në fusha të ndryshme si teknologjia, arti, bujqësia dhe zejet duke i prezantuar të rinjtë me mundësi lokale dhe kombëtare trajnimi dhe punësimi, në përputhje me profilin e tyre.

Përsa i përket edukimit të të rinjve, veç arsimit të lartë në fokus ishte edhe arsimit profesional si një nga prioritetet e qeverisë për të orientuar të rinjtë drejt profesioneve që u përshtaten dhe për të cilat tregu ka nevojë. Për më tepër, në panair të rinjtë u njohën edhe me programet e qeverisë si Programi i Kodimit dhe Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, si dhe me projektet rinore që zbatohen në qarkun e Fierit me financimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Nisma “Panair Edukimi, Trajnimi dhe Punësimi në çdo qark” e lançuar në muajin qershor 2023 nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zhvillohet në kuadër të plotësimit të qëllimit të dytë politik të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 me qëllim informimin e të rinjve mbi mundësitë që kanë në dispozicion për edukim, trajnim dhe punësim. Kjo nismë deri më tani ka **informuar rreth 2,600 të rinj në 9 qarqe të vendit**, dhe do të vijojë edhe në qarqet e tjera me qëllimin për të shkuar pranë të rinjve të vendit tonë.



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



03

360° RINI, FESTUAM DITËN E VERËS ME TË RINJTË NË LIQENIN E PASKUQANIT

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, këtë 14 Mars fokusoi festimet e Ditës së Verës në Liqenin e Paskuqanit, për të qenë më pranë të rinjve të kësaj zone dhe qindra të rinjve të Tiranës që zgjodhën t'i bashkohen kësaj feste. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Kryetarja e Kuvendit znj. Lindita Nikolla, Kryetari i Bashkisë Z. Rakip Suli dhe Drejtuesja e World Vision Albania Znj. Eljona Elmazi, festuan me të rinjtë dhe banorët e zonës, duke sjellë më shumë mundësi argëtuese për të rinjtë e Kamzës. Në 360° Rini, me mijëra të rinj, por jo vetëm u bashkuan në festimet për Ditën e Verës me këngëtar e grupe muzikore më në zë të cilët dhuruan emocione pafund dhe performancë live që ndezën skenën dhe zemrat e qytetarëve në këtë ditë vere.

Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz, me financimin e World Vision Albania.



04

GRAMSH - NJË DITË DEDIKUAR PROGRAMEVE PËR RININË DHE FËMIJËT

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët e shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh ndoqi programet për rininë dhe fëmijët, me qëllim monitorimin e ecurisë së tyre, impaktin tek fëmijët dhe të rinjtë, si dhe për të biseduar me përfuturit e programeve rreth çështjeve që mund të përmirësohen. Monitorimi filloi nga Programi i Kodimit në Shkollë, për të kaluar tek Programi Jashtë Orarit Mësimor, Programi i Ekipëve Sportive, Programi AI for Youth dhe deri tek një trajnim nga organizata rinore Konkret mbi Sigurinë Kibernetike, që zbatohet në tre bashki të qarkut Elbasan, me financim të Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Më tej, Ministri i Shtetit për Rininë dhe fëmijët zhvilloi një bisedë edhe me Këshillin Vendor Rinor, nga ku u evidentua plotësimi i kërkesave të parashtrura nga të rinjtë e Gramshit gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë në vitin 2021 si ngritja dhe fuqizimi i Këshillit Vendor Rinor edhe nëpërmjet organizatave rinore; Zbatimi i Programit Ekipet Sportive në Shkollë, Zbatimi i Programit Jashtë Orarit Mësimor me fokus në aktivitetet kulturore; dhe laboratorë teknologjik për zbatimin e Programit të Kodimit në Shkollë. Gjatë takimit me Këshillin Vendor Rinor të rinjtë parashtruan edhe kërkesat e reja që do të ndiqen në vijim.



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



05


BASHKËBISEDIME ME TË RINJ DHE FËMIJË NË FUSHA TË NDRYSHME

Përgjatë muajit mars, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka realizuar një sërë bashkëbisedimesh me fëmijë dhe të rinj të fushave të ndryshmeve për të qenë më pranë tyre, si dhe për të marr këndvështrimin e tyre për çështje që kanë nevojë të adresohen.

Në Kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, zhvilluan një takim me të rinjtë e Grupimit Rinor Rural, një rrjet me rreth 250 të rinj të cilët kanë pasion agroturizmin, bujqësinë dhe blegtorinë. Në këtë takim të rinjtë treguan pasionet dhe angazhimet e tyre në fusha të ndryshme si: agroturizmi, bujqësia, blegtoria dhe bletaria, si dhe për dëshirat e tyre për të ruajtur dhe trashëguar traditat familjare për të kontribuar në Shqipëri. Gjithashtu ata biseduan dhe treguan mbi sfidat dhe vështirësitë që ata hasin në zonat rurale.

Me djemtë dhe vajzat e KF Bashkimi, biseduan për rëndësinë e sportit si dhe punën fantastike që ka bërë trajneri për krijimin e këtij ekipi në Shkodër. Përgjatë takimit, fëmijët përcollën dhe shumë kërkesa të cilat do të ndiqen në vijim për t'u siguruar që fëmijëve t'i jepen të gjitha mundësitë për të shprehur dhe zhvilluar talentet e tyre.

Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti Klubin e Leximit nga shkolla 9-vjeçare "Ahmet Gashi", të cilët pikturuan, recituan e kënduan, dhe njëkohësisht nuk ngurruan as të shprehin dëshirat dhe kërkesat e tyre.



06

MBAHET MBLEDHJA E DYTË E KËSHILLIT KOMBËTAR TË RINISË

Me kërkesë të Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR) që funksionon si organ këshillues pranë ministrit përgjegjës për rininë u zhvillua takimi i dytë me anëtarët e KKR-së, me praninë edhe të drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në cilësinë e kryetarit të KKR-së drejtoi mbledhjen, **ku anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë diskutuan dhe propozuan zgjidhje për disa nga çështjet që ata parashtruan, duke filluar nga ndërveprimi KKR - KVR, për të kaluar më tej tek rritja e mundësive të fuqizimit të KKR-së për të qenë më pranë të rinjve dhe për të tejçuar zërin e tyre.**

Në fokus të bisedës ishte edhe thirrja e tretë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë për grante për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të cilën u prezantuan të gjitha procedurat transparente të ndjekura përgjatë thirrjes, dhe projektet fituese për 6 hapësirat rinore që do investohen në bashkitë e Fierit, Matit, Malësisë së Madhe, Sarandës, Librazhdit, dhe Korçës.

Një tjetër pikë diskutimi ishte edhe rishikimi i Ligjit 75/2019 "Për Rininë", për të cilin KKR-në do të jetë i pranishëm në çdo hap për të rishikuar çdo hapësirë që duhet plotësuar që ligji të jetë i zbatueshëm dhe produktiv në shërbim të të rinjve.



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



07

LEKSION I HAPUR ME STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK TË TIRANËS MBI POLITIKAT RINORE

Në kuadër të leksioneve të hapura me të rinjtë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një bisedë me studentët e fakultetit të Ekonomikut në Tiranë, me fokus tek programet për të rinjtë, për fuqizimin, arsimimin, punësimin dhe mirëqenien e tyre. Në fokus të bisedës ishin dhe një pjesë e programeve për të rinjtë sipas interesave të tyre duke përfshirë: Panairët e Edukimit, Trajnimit dhe Punësimit, Garancia Rinore, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, Programi i Kodimit, thirrja për startupe, si dhe thirrja për projekte rinore nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.



08

ECURIA E PROGRAMIT EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA DHE KAMPIONATI NË NIVEL QARKU

Përgjatë muajit mars, në kuadër të Programit të Ekipeve Sportive në Shkolla ka filluar kampionati në nivel brenda qarku, ku skuadrat fituese kualifikohen për të kaluar në fazën tjetër të kampionatit. **Deri më tani janë zhvilluar mbi 850 ndeshje për disiplinën e volejbollit dhe basketbollit për djem dhe vajza si pjesë e kampionatit të Ekipeve Sportive në Shkolla.** Programi Ekipeve Sportive në Shkolla ka filluar të zbatohet në vitin 2021 duke përfshirë mbi 10 mijë fëmijë dhe të rinj që trajnohen tre herë në javë me bazë materiale të siguruar nga qeveria shqiptare. Këtë vit programi po pilotohet edhe për grupmoshën 8-10 vjeç ku janë angazhuar mbi 1500 nxënës.



09

FINALIZOHET NJË TJETËR PROJEKT MBËSHËTETUR NGA THIRRJA E TRETË E AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË PËR PROJEKT PROPOZIME RINORE.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në eventin përmbyllës të projektit "Aktivizimi dhe nxitja e të rinjve për një ambient të shëndetshëm dhe social" zbatuar nga Shoqata Ressegnatia, me mbështetjen financiare nga Thirrja e Tretë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë në bashkitë Elbasan, Belsh dhe Peqin.

Në këtë projekt janë angazhuar 1000 të rinj, prej të cilëve 50% vajza dhe 50% djem, të cilët kanë mësuar si të jenë pjesë aktive e shoqërisë, me fokus kryesor krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe social që përmirëson cilësinë e jetesës së tyre.



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Mars



10

DREJTUES PËR NJË DITË NGA JUNIOR ACHIEVEMENT ALBANIA PRANË EKIPIT TË RINISË

Në kuadër të programit të **Junior Achievement "Lider për një ditë"**, Emi nga gjimnazi "Harry Fultz", iu bashkua ekipit të rinisë ku mësoi më shumë rreth secilit prej anëtarëve të ekipit dhe detyrave të tyre. Gjatë ditës të kaluar pranë MSHRF, Emi u njoh edhe me Strategjinë Kombëtare të Rinisë, si dhe programet që për fëmijët dhe të rinjtë, që plotësojnë kërkesat e tyre dhe ndikojnë në një stil jete të shëndetshëm dhe produktiv.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në eventin e njëmbëdhjetë të Junior Achievement Albania një organizatë që ndikon drejtpërdrejtë në edukimin ndër breza duke promovuar sipërmarrjen dhe potencialin rinor. Eventu bëri bashkë të rinjtë pjesë e programit, por edhe drejtues të bizneseve, institucioneve publike, mediave dhe organizatave jofitimprurëse që u dhanë mundësinë të rinjve të eksplorojnë leadershipin dhe cilësitë e tij.



11

AKTIVITETE TË ZHVILLUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTEVE FITUESE NGA THIRRJA E TRETË E AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

Në kuadër të thirrjes së tretë për projekt propozime rinore, financuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, organizata "The Door" ka filluar zbatimin e projektit "Rinia në Veprim". **Kjo organizatë synon të promovojë përfshirjen sociale për një jetesë aktive, për të rinjtë në komunitet rurale dhe urbane të Bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Malësi e Madhe dhe Pukë.** Përgjatë implementimit të projektit, të rinjtë do të angazhohen në aktivitete sportive dhe edukative për t'u njohur më nga afër me natyrën, kulturën dhe traditat e zonave të tyre.

Në kuadër të projektit "Tradita në Lëvizje" e cila ka si qëllim ruajtjen dhe rritjen e formave tradicionale të valles popullore dhe asaj të kultivuar, organizata Mega Art zhvilloi trajnimin dhe workshopin e radhës në **qytetin e Durrësit në ambientet e shkollës "Olsi Lasko"**. Në këtë aktivitet morën pjesë 47 të rinj të cilët u njohën me vallen popullore dhe vlerën e saj historike.

